

L I G J
Nr. 8521, datë 30.7.1999

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8087, DATË 13. 3. 1996 “PËR
SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8087, datë 13. 3. 1996 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Titulli i ligjit nr. 8087, datë 13. 3. 1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” ndryshohet si vijon:

“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar”

Neni 2

Pas nenit 1 shtohet neni 1/1 me këtë përmbajtje:

“Përfitojnë sipas këtij ligji ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik, të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe ish-ushtarakët e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Vjetërsia e shërbimit si ushtarak aktiv për efekt të përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi llogaritet nga dita e titullimit oficer apo nënoficer në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik, të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe të ish-Ministrisë së Brendshme.”

Neni 3

Neni 2 ndryshohet si vijon:

“Përfitimet nga ky ligj financohen dhe garantohen nga buxheti i shtetit. Llogaritja, caktimi dhe pagimi i përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj, me përjashtim të atyre të përcaktuara në nenet 8, 10 e 17 bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë udhëzimin përkatës.”

Neni 4

Neni 3 ndryshohet si vijon:

“Të drejtën e përfitimit, sipas këtij ligji, e kanë ushtarakët që kanë dalë në rezervë ose në lirim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7496, datë 3. 7. 1991 “Për statusin e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.”

Neni 5

Paragrafi i fundit i nenit 7 ndryshohet si vijon:

“Paga referuese është paga bazë për funksionin dhe shpërblimi për gradën ushtarake që kishte ushtaraku në çastin e daljes në rezervë apo në lirim.

Pagë bazë për efekt përfitimi nga ky ligj konsiderohet:

a) Për ushtarakun që ka dalë në rezervë ose lirim para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji është paga që ka ushtaraku në po atë funksion në momentin e shtrirjes së efekteve financiare të këtij ligji.

b) Për ushtarakun që del në rezervë ose lirim pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, është paga që ka ushtaraku në po atë funksion në momentin që lind e drejta e përfitimit. ”

Neni 6

Neni 11 ndryshohet si vijon:

“Pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi

Ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm, që kanë dalë në rezervë e në lirim pas datës 3. 7. 1991 deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11. 5. 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kur plotësojnë vjetërsinë e shërbimit si ushtarak në masën 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat dhe të kenë mbushur moshën: gratë 42 vjeç dhe burrat 47 vjeç.

Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të jetë:

a) 50 për qind të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi.

b) Për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohet me 2 për qind të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi.

Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet pasi përfituesit i ka përfunduar periudha e trajtimit me pagesë kalimtare, sipas nenit 10 të ligjit nr. 8087, datë 13. 3. 1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndërpritet kur përfituesi rritullohet ushtarak aktiv apo punësohet.

Periudha që ushtaraku përfiton pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi njihet si vjetërsi sigurimi për efekt përfitimi pension pleqërie, sipas pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr. 7703, datë 11. 5. 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 7

Paragrafi i parë i nenit 12 ndryshohet si vijon:

“Ushtaraku, që është efektiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i Ministrisë së Rendit Publik, i Shërbimit Informativ Kombëtar dhe i ish-Ministrisë së Brendshme, kur ka plotësuar kushtet për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 4171, datë 13. 9. 1966 “Për sigurimet shoqërore në RPSH” dhe të ligjit nr. 7703, datë 11. 5. 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të marrë pension suplementar pleqërie si ushtarak. ”

Neni 8

Paragrafi i parë i nenit 13 ndryshohet si vijon:

“Ushtaraku, që është efektiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i Ministrisë së Rendit Publik, i Shërbimit Informativ Kombëtar dhe i ish-Ministrisë së Brendshme, përfiton pension invaliditeti të plotë a të pjesshëm, sipas ligjit nr. 4171, datë 13. 9. 1966 “Për

sigurimet shoqërore në RPSH” dhe ligjit nr. 7703, datë 11. 5. 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, gëzon edhe të drejtën e pensionit suplementar të invaliditetit si ushtarak.”

Neni 9

Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me këtë përmbajtje:

“Nga ky ligj nuk përfitojnë ushtarakët e nxjerrë në lirim për braktisje detyre, si dhe ata që janë dënuar me burg nga gjykata me vendim të formës së prerë për krime ushtarake. ”

Neni 10

Efektet e zbatimit të këtij ligji shtrihen nga data 1 janar 1999.

Neni 11

Kudo që në ligjin nr. 8087, datë 13. 3. 1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” është përdorur shprehja “paga neto mesatare e vitit të fundit të shërbimit”, zëvendësohet me termin “pagë referuese”.

Neni 12

Kudo ku në ligjin nr. 8087, datë 13. 3. 1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” përdoret emërtimi: Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, zëvendësohet me emërtimin “Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik, të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe ish-Ministrisë së Brendshme”.

Neni 13

Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 2442, datë 19.8.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**